



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:121525

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05588557

P.nr.97/20223

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, dhe bashkëpunëtorja profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit V (M) D, me banim në K, Lagja e re D-K. K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II.nr.878/2023 të datës 06.06.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 27.03.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit V.D dhe mbrojtësit të tij i caktuar EX oficio, av.Rrahman Bashota, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 27.03.2024, palët heqin dorë nga shpallja e aktgjykimit, ndërsa me datë 18.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

V. D i lindur me në K.P, tani me banim në K, L e re D-K.K, nga babai M dhe e ëma F e vajzërisë H i, ka të kryer Fakultetin Juridik, me profesion Jurist, i pa martuar i punon në Kompaninë Gjermane „C.C”, identifikuar me numër personal....., i nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se: I pandehuri, V. D

I.Pasi më parë ka siguruar e gjerë me datë, rreth orës, në fshatin D. K. K, pikërisht në shtëpinë e tij pa autorizim ka poseduar armë dhe municion në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për armët të Republikës së Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara dhe atë një (1) Pistolet me gazë markës Ekol Special Model 99 cal. 9 mm EU13 dhe 19 , gëzhoja kal.9 mm në atë mënyrë që pas pranimit të informatës nga policia se në fshatin kishte të shtëna me armë pasi kishte kontaktuar me të pandehurin i cili kishte pranuar se posedon armën me të cilën kishte përdorur duke gjuajtur në fejesën e vëllaut të tij, e cila së bashku me gëzhojat janë konfiskuar nga ana e policisë.

- me këtë ka kryer vepër penale,, Mbjajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

II.Me datë 02.05.2023 rreth orës 21:27 minuta në fshatin D.K.K, pikërisht në oborrin e shtëpisë së tij ka përdorur armën të markës Pistolet C..., prodhimit Qek nr.serik C... ngjyrë të zezë 57 cal.9 mm, në kundërshtim me nenin 18 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës edhe pse posedon leje valide për lëvizje të lëshuar nga MPB të Kosovës, në atë mënyrë që mbrëmjen kritike rreth orës në fshatin D.K e K, pikërisht në oborrin e shtëpisë së tij me ahengun familjar në shenjë gëzimi ka nxjerr revolen duke shtënë 19 here në ajër (përplotë) ashtu që pasi policia shkon në shtëpinë e të pandehurit me atë rast e sekuestron armët dhe municionin e lartcekur.

- me këtë ka kryer vepër penale “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm ” nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 48, 47 dhe 69 dhe 70 dhe nenit 359 par. 3 lidhur me par. 2 dhe nenit 320 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT DHE DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit V. D, Gjykata i përcakton sipas dispozitivit -1- dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nuk kryen vepër të re penale, ndërsa sipas dispozitivit -II- e dënon me dënim me Gjobë në shumën prej 700 (shtatëqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

ME DËNIM UNIK

Konform nenit 76 të KPRK-së.

Gjykata e dënon me Dënim Burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një(1) viti, nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

DËNIM ME GJOBË

Shuma në vlerë prej (700) shtatëqind €, të cilin denim i pandehuri ta paguaj me këste në afat prej dy (2) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Mundësia e pagesës me këste, do të revokohet nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë.

2.Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës.

III.OBLIGOHET: I pandehuri qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

IV. Konfiskohen: Konform nenit 235 par. 1 nën. par 1.9 të KPRK-së, lidhur me nenin 366 par. 3 të KPRK-së: një (1) Pistolet me gazë markës Ekol Special Model 99 cal. 9 mm EU13 dhe 19 , gëzhoja kal.9 mm.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP//II.nr.878/2023 të datës 06.06.2023 ndaj të pandehurit V (M) D, nga K, lagja e re D.K.K, dhe mbrojtësit të tij të caktuar EX oficio av. Rrahman Bashota, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale mbajtje në pronësi kontrollë ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.27.03.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i akuzuari, V. D dhe mbrojtësi av. Rrahman Bashota.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barre, më vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shpreh pendesë për veprën penale të kryer. I pandehuri ka deklaruar se nuk kam qenë i vetëdijshëm se përdorimi i armës me gaz ka qenë vepër penale.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit e po ashtu edhe të mbrojtësit të pandehurit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që i pandehuri pranoi fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresë të lënda. I propozoj Gjykatës që të pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale që i vihet në barrë, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit av. Rrahman Bashota ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim, kërkoi nga gjykata që të ketë lehtësira, me rastin e marrjes së vendimit, duke pas parasysh se i pandehuri ka përdorur armën në

oborrin e shtëpis së vet jo diku tjetër, e ka përdor armën për fejesën e vëllaut të vet, për gëzim, është student nuk ka dëshmi se ka kryer vepra tjera. Duke e marrë parasysh se vet e ka dorëzuar armën, kërkoi nga gjykata që me rastin e marrjës së vendimit të ketë parasysh gjendjen e dobët ekonomike dhe ti shqiptoi një dënim më të butë.

I pandehuri kërkoi nga gjykata që ti shqiptoi një dënim më të butë pasi është mbajtës i vetëm i familjes, po ashtu arma është përdorur në oborrin e shtëpisë. Jam student i fakultetit juridik i vitit të tretë, jetoj me prind, ku qdo ditë pothuajse më duhet ti dërgoi te mjeku pasi qe të dytë janë në gjendje të rëndë shëndetësore.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale, mbajtje në pronësi kontrollë ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në

kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe pendimin e tij, padënueshmërinë e tij më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri vetë e ka dorëzuar vullnetarish pushkën të cilën e ka poseduar pa leje përkatëse, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi Unik me burgim iu shqiptua në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti nuk kryen vepra të re penale. Si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 700 (shtatëqind) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj me dy rata pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për

Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.97/2023 me datë 18.04.2024

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

Bashkëpunatore Profesionale
Fatmire Elezaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.